



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 403/13 Prot.

Tiranë, më 25.02.2026

VENDIM

Nr. 17 Datë 25.02 2026

**“PËR
MIRATIMIN E NIVELIT TË RI TË PAGAVE TË PUNONJËSVE MBËSHTETËS
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë" neni 49 , mbështetur në Vendimin nr. 87, datë 06.02.2026 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 326, datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", të ndryshuar, pika 1, 2, mbështetur në Relacionin e adm. Nr 365 datë 18.02.2026, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 25.02.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e nivelit të ri të pagave të stafit mbështetës në UST, sipas tabelës :

Nr.	Emërtimi I punonjësit	Klasa e pagës	Paga bazë për klasë ishte	Paga bazë për klasë bëhet
1	Punonjës pastrimi/sanitar	I-rë	44,000	50,000
2	Punonjës mirëmbajtje	III	45,800	51,800
3	Teknik I mesëm I specialiteteve të ndryshme, shofer	V	47,000	53,000
4	Llogaritar	VI	48,000	54,000

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv Protokollit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI

